

Koncept Këshillëdhënës

Siç është konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese, Asociacioni/Komuniteti i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është një obligim ligjor për Kosovën që derivon nga Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë për Principet Qeverisëse të Normalizimit të Marrëdhënieve.

Anash observimeve të bëra nga Gjykata Kushtetuese, autoritetet e Kosovës shpesh kanë theksuar se kapaciteti legal i Asociacionit duhet të jetë identik me atë ekzistuesin që është Asociacioni i Komunave të Kosovës, aktualisht i regjistruar dhe me veprim si Organizatë Jo Qeveritare.

Ekipet ligjore që këshillojnë autoritetet e Kosovës do të duhej të vinin në pah figurën/strukturën e cunguar ligjore të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Fatkeqësisht, Gjykata Kushtetuese gjithashtu ka dështuar për të theksuar këtë figurë të cunguar ligjore të këtij Asociacioni aktual.

Ky dokument njih shqetësimet politike dhe legale të ndërlidhura me formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Gjithsesi, eksplorimi i mundësive për të adresuar këto shqetësime mund të bëhet vetëm pasi palët të zgjidhni çështjet që kanë të bëjnë me strukturën legale të organizmave të mëhershëm të themeluar nga komunat.

Të metat legale të Asociacionit aktual të Komunave të Kosovës

Autoritetet e Kosovës, përfshirë presidenten, argumentojnë se ndërtimi ligjor i Asociacionit ekzistues të Komunave të Kosovës buron nga Ligji i Vetëqeverisjes Lokale.

Neni 31 – Të drejtat e komunave për të formuar asociacione

Për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tyre të përbashkëta, komunat formojnë dhe marrin pjesë në asociacionet që funksionojnë, në pajtim me ligjin.

Autoritetet e Kosovës thonë se “ligji” i referohet Ligjit Për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, pasi që Asociacioni ekzistues i Komunave të Kosovës ekziston sipas dispozitave dhe procedurave të këtij ligji.

Autoritetet e Kosovës, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, kanë injoruar faktin se Ligji Për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare buron nga neni 44 i Kushtetutës.

Neni 44 (Liria e Asociimit)

Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.

Artikulli 4 i ligjit në pyetje, kapitulli për principet fundamentale, qartësisht reflekton të njëjtën gjë.

- 1. Liria e asociimit është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*
- 2. Liria e asociimit përfshinë të drejtën e secilit person për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.*
- 3. Çdo person ka të drejtë të themelojë organizatë joqeveritare, në pajtim me kushtet dhe rrethanat e përcaktuara me këtë ligj.*
- 4. Asnjë person nuk obligohet që të asociohet kundër vullnetit të tij.*
- 5. Asnjë person nuk diskriminohet në asnjë mënyrë për shkak të vendimit për t'u asociuar apo për të mos u asociuar.*

Duhet t'ua kujtojmë palëve se neni 44 i Kushtetutës i referohet Lirisë për Asociim si një nga të drejtat dhe liritë fundamentale të garantuara nga Kushtetuta e Kosovës. Është e drejtë fundamentale dhe liri e dhënë për individët dhe vetëm për individët. Pra, kjo reflektohet edhe në ligj gjithashtu.

Me këtë ligj, Asociacionet janë të formuara nga qytetarët e lirë. Neni 16 i Ligjit Për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare thotë:

Neni 16

- 1. Shoqata është organizatë e anëtarësisë, e grupuar në bazë të vullnetit të lirë të personave me interes të përbashkët, për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë.*
- 2. Shoqata themelohet nga tre (3) ose me shumë persona.*

Sipas të dhënave zyrtare, Asociacioni ekzistues i Komunave të Kosovës (Akronimi AKK, Asociacion OJQ, me numër regjistrimi 5101800-1) është një organizatë e themeluar jo nga komunat, por nga tre individë në kapacitetin e tyre si persona privat. Zotëri Faruk Spahija, Lutfi Haziri dhe Sali Gashi, janë të listuar si themelues të AKK-së.

Si mundet që një organizatë e themeluar nga tre qytetarë privatë të përfaqësojë Komunat e Kosovës përbën një mister ligjor.

Neni 13, pika 1, i të njëjtit ligj thotë:

OJQ ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga institucionet publike.

Në këtë pikë, duhet të shohim definicionin gjerësisht të pranueshëm, nga pikëvështrimi ligjor, se çfarë është një komunë.

Komuna është një nënndarje politike e një shteti brenda të cilit është krijuar një korporatë komunale për të siguruar qeverisjen e përgjithshme lokale, e përqendruar për një popullatë specifike e përqendruar në një zonë të caktuar.

Çdo ekspert ligjor/politik do të çuditej, meqë komunat janë pjesë përbërëse e institucioneve të shtetit, si mundet që një organizim i themeluar prej tyre të jetë i pavarur nga shteti?

Si një pjesë përbërëse e strukturës së përgjithshme qeverisëse, komunat nuk gëzojnë lirinë e asociimit e dhuruar për individët nga Kushtetuta. Çfarëdo nocioni që komunat mund të themelojnë OJQ që më pas të përfaqësohen përmes saj përbën një nonsens burtal ligjor.

Autoritetet e Kosovës duhet menjëherë të anulojnë regjistrimin e AKK-së, pasi që ekzistimi i AKK-së, si një OJQ, përbën shkelje flagrante të ligjit dhe tallje (hajgarllëk) me principet fundamentale demokratike të qeverisjes.

Konceptimi i personalitetit/trupit juridik të organizatave të themeluara nga komunat

Siç vërehet nga Gjykata Kushtetuese, komunat kanë të drejtë kushtetuese të bashkëpunimit ndër-komunal (neni 124.4).

Në vitin 2011, Asambleja e Kosovës kaloi Ligjin për Bashkëpunim Ndër-komunal (Ligji Nr.04/L-010). Gjithsesi, ky ligj do të duhej të mbulonte të drejtën e

komunave për asociim, siç theksohet në kapitullin V (5) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kapitulli V (Bashkëpunimi ndërkomunal dhe aranzhmanet brenda komunale) nga Ligji i vitit 2008 për Vetëqeverisje Lokale vë themelin për eksplorimin e kësaj të drejte.

Për nevojën kaq të madhe të përshtatshmërisë ligjore, rrugë ma e mirë është të draftohet një ligj i ri me emrin “Ligji për Bashkëpunim dhe Koordinim Ndërkomunal”, që po ashtu mbulon të drejtën e komunave për t’u asociuar, dhe efektivisht anulon Ligjin Nr.04/L-010.

Meqë “bashkëpunimi” i referohet përpjekjes kolektive nga një grup për të arritur objektiva partikulare dhe “koordinim” i referohet një rregullimi të zakonshëm të përpjekjeve të një grupi për të siguruar unitet veprimi në ndjekjen e objektivave të përbashkëta, duke përfshirë këtu edhe objektiva partikulare edhe ato të përbashkëta, ofron një shtrirje më të gjerë.

Neni 81 i Kushtetutës e rregullon se një ligj i tillë do të binte në legjislacionin me interes vital që kërkon rregullin e shumicës së dyfishtë. Rregulli i shumicës së dyfishtë dikton domosdoshmërinë e pjesëmarrjes aktive të deputetëve serbë të Kosovës në procesin legjislativ.

Ky ligj do ofronte një kornizë të përgjithshme për strukturën organizative, objektivat, aktet ligjore të qeverisjes, procedurat për ta themeluar dhe zhbërë, raportin me autoritetet qendrore, buxhetin, kapacitetin legal dhe aspekte të tjera organizative të themeluara nga komunat për bashkëpunim dhe koordinim ndërkomunal.

Të menduarit praktik (common sense) dhe vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese do të udhëhiqnin ligjbërësit në procesin draftues.

Ligji duhet ta përcaktojë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si struktura qeverisëse e mbikëqyrjes. MAPL-ja do të shërbente gjithashtu si zyra e regjistrimit për themelimin dhe zhbërjen e këtyre organizatave. Për këtë qëllim, MAPL-ja do të duhej të adoptonte disa direktiva specifike administrative.

Ky ligj do të ofronte bazën ligjore të nevojshme për strukturën e duhur ligjore për ekzistimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, dhe çfarëdo organizate tjetër në të ardhmen, përfshirë edhe Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Observime shtesë

Dikush mund të argumentojë, në terme të thjeshtëzuar, se struktura ligjore e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe mund të rrjedhë vetëm nga Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve.

Megjithatë, në përpjekje për të konceptuar strukturën juridike shumë të nevojshëm të organizatave të themeluara nga komunat, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KO130/15 i datës 23 dhjetor 2015 dikton një opinion më të gjerë juridik.

Neni 19.1 i Kushtetueses thotë:

Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.

Siç kemi parë në vitet e kaluara, Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve nuk është i vetëzbatueshëm. Shpallja e Ligjit për Bashkëpunim dhe Koordinim Ndërkomunal bie në kategorinë e aseteve të nevojshme ligjore të parapara me nenin 19.1.

Shpallja e këtij Ligji gjithashtu do të përmbushte obligimet ligjore të parapara në pikën dy të Marrëveshjes së Parë të Principeve, ku theksohet:

Asociacioni/Komuniteti do të krijohet nga statuti. Zhbërja do të bëhet vetëm me një vendim të komunave pjesëmarrëse. Garancitë ligjore do të sigurohen nga ligji në fuqi dhe ligji kushtetues (duke përfshirë rregullin e shumicës prej 2/3).

Si ligj me interes vital, Ligji për Bashkëpunim dhe Koordinim mund të ofrojë këto garanci ligjore.

Ligji për Bashkëpunim dhe Koordinim Ndërkomunal dhe vendimet administrative që derivojnë nga ky ligj mund të prezantohen para Gjykatës Kushtetuese për një shikim final.

Konkluzione

Lansimi i diskutimeve/konsultimeve serioze në draftimin dhe shpalljen e Ligjit për Bashkëpunim dhe Koordinim Ndërkomunal është rruga më e mirë për të tejkaluar bllokimin shumë vjeçar.

Përveç zgjidhjes së problemit për strukturën ligjore të Asociacionit ekzistues të Komunave të Kosovës, ky ligj gjithashtu do të do të mundësonte principin e barazisë ligjore për të gjitha organizatat që formohen nga komunat, përfshirë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Shpallja e Ligjit për Bashkëpunim dhe Koordinim Ndërkomunal ofron kornizën për të adresuar shqetësimet e ngritura nga Gjykata Kushtetuese dhe njëkohësisht arrin objektivat e marrëveshjes së vitit 2015 për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Diskutimet/konsultimet gjithashtu mund të jenë ndihmuese në gjetjen e formulave për të adresuar të tjera shqetësime në raport me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Duke marrë këto veprime, Kosova demonstroi përkushtimin për rend dhe ligj dhe seriozitetin e vet si një partner kredibil i komunitetit ndërkombëtar.